

**NE EMER TE POPULLIT**

*Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i pergjithshem- dega në Novobërdë, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me proqesmbajtsen Mimoza Mehmeti, në qështjen penale kundër të akuzuarit B.M nga fsh.L., Komuna e N., për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 para 4 lidhur me parag. 1 të KPK-së, dhe mbajtja në pronësi, posedim, kontrollë apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve pa leje nga neni 328 para 1 të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokuroris Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.1040-3/09 të dates 08.04.2011 pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë. 07.11.2016 ndërsa me date 08.11.2016 mori dhe shpalli këtë,*

**A K T G J Y K I M**

*I akuzuari B. M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga babai, G., dhe e ëma A., e lindur, H., i lindur me në fsh.L., ku dhe jeton, Shqiptarë shtetas i R, Kosovës, i martuar, babe i dy fëmijve ka të kryer shkollën e mesme, punësuar në firmën "Onix", i gjendjes se varfër ekonomike, me pare i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet ndonji procedur tjetër penale.*

*Konform nenit 363 par.1 nën para, 1.3 të KPPK-ës, për shkak të heqjes dorë nga akuza.*

**REFUZOHET AKUZA**

*I. Sepse me date 08.02.2009, rreth ores 17:00, në shtëpin e tij në fsh. Ll., Komuna e N., me dashje I ka shkaktuar lëndime trupore bashkshortës së tij tani të dëmtuarës L. G., në atë mënyrë që pas një grindje mes tij dhe të dëmtuarës, i njejt ka përdorur forcën fizike, dhe nën kërcnim të armës e ka goditur në pjesën e shpinës ( të hollët) veshkëve me kondak të pushkës (10), me që rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore,*

*Me qka kishte për të kryar veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 4 lidhur me para. 1 të KP të Kosovës.*

*E dëmtuara L. G., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.*

***I akuzuari B. M.,***

### ***ESHTE FAJTOR***

*II. Sepse pas kryerjes së veprës penale të përshkruar si më lart në dispozitivin I. të këtij aktgjykimi, i akuzuari ka shtënë dy here me armë të tipit të panjohur, me qëllim të kërcnimit, ndaj të dëmtuarës L. G.*

*Me qka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, posedim ,kontroll apo shfrytëzim të armëve pa leje nga neni 328 para 1 të KPK-ës,*

*Andaj gjykata në pajtim me neni 4, 41, 51, 52, 53,,73, 75 si dhe neni 365 të KPPK –ës.*

### ***E GJYKON***

*Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i akuzuari nuk do ta mbajë, ne qofte se të në afat prej 1(një) vite ,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonje vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të revokohet.*

*I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.*

### ***A r s y e t i m***

*Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë me aktakuzën PP. nr.1040-3/2009 prej dates 08.04.2011 e ka akuzuar B. M. nga, fsh.L., Komuna e N., për shkak te veprave penale lëndim i lehtë trypor, nga neni 153 par 4 lidhur me para.1 të KPK-se. dhe mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-ës.*

*Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me date 07.11.2016, prokurori shtetit Shefik Memeti ka deklaruar se: para leximit të aktit akuzues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në dispozitivit I. të aktakuzës, shifet se kemi të bëjmë me veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 parag.4 lidhur me para.1 të KPK-ës, e cila është kryer me date. 08.02.2009 ndërsa për këtë veprë ligjvënsi ka parapar se për këtë veprë penale denimi është parapar prej 6 (gjashtë) muaj deri në 3 (te) vite burgim, dhe në bazë të kësaj shifet se kjo veprë penale është përfshir me parashkrim absolut të veprës, dhe me nenin 106 par. 1 nën para, 1.5 të KPPK-es, thuhet se vepra penale përfshihet me parashkrim në afat prej tre vitesh nga dita e kryerje e veprës penale të denueshme me më shumë se 1(nji) vit burgim e kjo do të thotë se nga koha e kryerjes së kësaj veprë penale kanë kaluar 6(gjashtë) vit dhe nga kjo arsye heq dorë nga ndjekja e veprë penale në dispozitivin I. të kësaj aktakuze. Ndërsa sa i përket dispozitivit II. të kësaj aktakuze mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK-ës, mbetem pranë të njëjtës dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe ti shqiptoj një denim meritator sipas ligjit gjithnjë duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.*

*I akuzuarit B. M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar e pranoj fajësinë për veprën penale si në dispozitivin II. të aktakuzës, mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ndiej keqardhje dhe pendohem për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i premtojmë gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk do të bëj ndesh me ligjin, se këtë pranim e bëj në mënyrë vullnetare edhe se jam në dajë për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. Andaj i propozoj gjykatës që të ma shqiptoj një denim sa më i butë, pasi që jam baba i dhjetë fëmijëve, i gjendjes së varfur ekonomike.*

*Megjithatë i akuzuari në seancën kryesore të kësaj qështje penale e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë qështje penale nuk është kontestuese, sepse përpos pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit një pranim i tillë ka edhe mbështetje në provat e grumbulluara të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, se injejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se aktakuzat nuk përmban asnjë shkelje ligjore, andaj gjykata e vazhdoj procesin ndaj të njëjtit me shqyrtimin e dënimit.*

*Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarin sa i përket veprës penale të cekur nën dispozitivin II. Të këtij aktgjykimi gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Keshtu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë qka do të thotë se të akuzuari ka pranuar të jenë bashkepunues, është penduar për veprën penale, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të biesh me ligjin, si dhe gjendjen e varfër ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe pasojën e shkaktuar nga kjo veprë penale. Andaj gjykata erdhi në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.*

*Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragrafi 1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së.*

*Gjykata konform nenit 463 paragrafi të KPRK-së, të dëmtuarën, për realizimin e kërkesës pasuror-juridik, udhëzohet në contest civil.*

*Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

*Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm*

*P.nr. 20/2016, më 08.11.2016*

*Proqesmbajtsja,  
Mimoza Mehmeti,  
Sadiku,*

*Gjyqtari,  
Hasan*

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

